



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 19.2.2024

Dokument parlamentar
(Komision përgjegjës)

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.81/2017, “PËR ZONAT E MBROJTURA”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, në mbledhjet e datës 13 dhjetor 2023, 30, 31 janar, 7, 12 dhe 19 shkurt 2024.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Laert Duraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit ishin edhe të ftuar nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Mirela Kumbaro, ministre, znj. Almira Xhembulla, zëvendësministre dhe nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministri z. Hantin Bonati.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura” është një nismë e një grupi deputetësh, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3, të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi përmbajtja dhe risitë e projektligjit**

Projektligji ka si qëllim rregullimin e disa problematikave që vijnë si pasojë e zbatimit të ligjit ekzistues, që lidhen kryesisht me bashkëpunimin ndërmjet qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura.

Këto problematika janë të tilla për shkak të qasjes së hartimit të ligjit në vitin 2017 si një ligj strikt mbrojtës, i cili nuk merr parasysh faktorin e komunitetit që bashkë ekziston në këto zona.

Aktualisht, në kushtet kur zonat e mbrojtura përbëjnë 21.5% të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, pra më shumë se 1/5 e vendit, lind nevoja dhe duhet të gjenden zgjidhje për të adresuar këto problematika pa kompromentuar parimet bazë të funksionimit të zonave të mbrojtura, atë të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre .

Për këtë arsye, ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektligji synojnë të sjellin koncepte të reja të kategorizimit të biodiversitetit në vend, sipas rëndësisë, por edhe mundësinë e përditësimit të tij në mënyrë më të shpeshtë, si dhe i jep një mundësi qeverisjes lokale dhe komuniteteve të jenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje.

- **Risitë e projektligjit**

Me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara nga zbatimi i ligjit ekzistues projektligji synon:

- të riformulojë parimet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke shtuar parimin e përshtatshmërisë" "parimin e kategorizimit të objektivave"dhe "parimin e fleksibilitetit të menaxhimit", me qëllim rritjen e efikasitetit në procesin e menaxhimit të këtyre zonave, duke u bazuar në parimet e IUCN.
- të riformulojë politikat shtetërore në fushën e zonave të mbrojtura, në kuadër të nevojës për një bashkëpunim/ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore, vendore si dhe shoqërinë civile, me qëllim administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen efikase të këtyre zonave.
- të rishikojë funksionet e institucioneve publike, në kuadër të nevojës për të përforcuar rolin e tyre nëpërmjet bashkërendimit dhe harmonizimit të punës së përbashkët, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura.;
- të garantojë aksesin e publikut në zonat e mbrojtura;
- të ripërcaktojë llojet e zonave të mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin është marrë statusi i mbrojtjes, duke shtuar edhe kategorinë "zona të mbrojtura me interes lokal/bashkiak, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të tyre nga institucionet e qeverisjes vendore;
- ti mundësojë bashkive të menaxhojnë një pjesë të zonave të mbrojtura, të cilat janë pjesë e territoreve përkatëse që administrojnë;

- të riformulojë objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura , me qëllim mbrojtjen e ketyre zonave me anë të rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit të publikut, nxitjen për kryerjen e aktiviteteve kërkimore-shkencore, nxitjen për kryerje të aktiviteteve rekreative dhe veprimtarive ekonomike në përputhje me parimin e efektivitetit, por dhe me objektivat e zonës së mbrojtur;
- të harmonizojë terminologjinë e ligjit me atë të IUCN-së;
- të riformulojë aktivitetet e lejuara apo të ndaluara në zonën e mbrojtur "Park Kombëtar".
- t'u japë mundësinë e zhvillimit të veprimtarive ekonomike banorëve të zonës, me qëllim që të kenë akses e të përfitojnë prej tyre;
- të lejojë përdorimin e tokës dhe kryerjen e aktiviteteve të cilat zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus zhvillimin ekonomik të zonës;
- të lejojë ndërhyrjet e lejuara urbane, rekreacionit apo industriale brenda zonës, por duke ruajtur karakterin e saj;
- të nxisë dhe të përkrahë nisma, projekte, programe dhe veprimtari që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjikë e natyrorë të një zone të mbrojtur mjedisore, ose që ndikojnë pozitivisht në to.

• ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe i harmonizuar me legjislacionin e brendshëm në fuqi.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me kërkesat e nenit 68 pika 2 të Rregullores së Kuvendit *(është në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me relacionin shpjegues ku përcaktohet qëllimi, objektivat dhe baza ligjore)*.

Në aspektin formal projektligji i propozuar përbëhet nga 22 nene, të cilët janë rishikuar në tërësi, si në aspektin përmbajtësor, me qëllim për të garantuar mbrojtjen/ruajtjen e vlerave të zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit, duke e harmonizuar me përcaktimet dhe parimet themelore të sanksionuara në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, por edhe në kuadër të teknikës legjislative.

• ***Vlerësimi përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, nuk përfron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit European (acquis e BE-së/ i.e Direktivë, Rregullore apo Vendim).

Ndërsa, vetë Ligji nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së ëgër”, të ndryshuar”, Numri CELEX 31992L0043.

- **Konsultimi Publik**

Në kuadër të shqyrtimit të këtij projektligji, në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, referuar edhe ndjeshmërisë së lartë mjedisore që ai përcjell, Komisioni zhvilloi një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi.

- **Kohëzgjatja e konsultimeve**

Procesi i konsultimi të projektligjit ka nisur me publikimin e tij në platformën “Konsultimi i projektligjeve” në faqen zyrtare të Kuvendit, nga data 7 deri në 21dhjetor 2023. Në të njëjtën kohë me publikimin në platformë ka nisur edhe komunikimi për marrjen e mendimeve të grupeve të interesit nëpërmjet adresës elektronike të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, të shkresave drejtuar Kryetares së Kuvendit, kryetarit të komisionit dhe deputetëve të Kuvendit.

Bazuar në përcaktimet e nenit 82, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 3 të Rregullores së Kuvendit komisioni ka kërkuar edhe mendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë projektligj.

Bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, komisioni zhvilloi seanca dëgjimore me përfaqësues të grupeve të interesit, të shoqatave/organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të dhe staf akademik të IAL-ve nga data 30 janar – 12 shkurt 2024.

- **Metoda e konsultimit**

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" janë:

- Publikimi i projektligjit në platformën “Konsultimi i projektligjeve” në faqen zyrtare të Kuvendit;
- komunikimi dhe mbledhja e mendimeve/komenteve/sugjerimeve përmes postës elektronike të Komisionit;
- takime të vazhdueshme (edhe online) me ekspertët e fushës;
- seanca dëgjimore në komision me përfaqësues të grupeve të interesit;

- dërgimi për mendim pranë Këshillit të Ministrave;
- administrimi i mendimeve të komisioneve parlamentare për dhënie mendimi.

➤ **Palët e interesit të përfshira në procesin e konsultimit**

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut gjatë procesit të konsultimit janë:

I. Organizata/shoqata mjedisore

1. Organizata “ILIRIA
2. Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)
3. Qendra “Shpendët e Shqipërisë”
4. Impetus
5. Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)
6. Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)
7. Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim
8. Qendra “Res Publica”
9. Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC)
10. Qendra mjedisore Eden
11. Konfindustria

II. Ekspertë /individë dhe staf akademik i IAL-ve:

1. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)
2. Silvana Xheka- individ
3. Studentet "Master Biologji Mjedisi I"
4. Aleko Miho, Fakulteti i Shkenvcave të Natyrës- individ- (FSHN)

➤ **Seanca dëgjimore të zhvilluara në Komision**

Bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore 10 me përfaqësues të shoqërisë civile/grupeve të interesit. Konkretisht:

1. Shoqatën Ornitologjike të Shqipërisë (AOS) - dt.30 janar 2024
2. Qendrën Shpendët e Shqipërisë - dt.30 janar 2024
3. Qendrën “Ruajtja e Ekosistemeve natyrore në Shqipëri” (EcoAlbania) - dt 31 janar 2024
4. Qendrën për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) -dt.31 janar 2024
5. Qendrën Burimore të Mjedisit në Shqipëri (REC) -dt. 7 shkurt 2024
6. Institutin për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) - dt.7 shkurt 2024
7. Qendra mjedisore “EDEN” - dt.7shkurt 2024
8. Organizata “Iliria” - dt.12 shkurt 2024
9. Co-Plan “Instituti për zhvillimin e habitateve” - dt.12 shkurt 2024
10. Shoqata e Bujqësisë Organike - dt.12 shkurt 2024

➤ **Përmbledhje e shqetësimeve/komenteve/sugjerimeve të përfaqësuesve të grupeve të interesit të prezantuara në KVPTM**

1. Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)

Shoqata AOS e përfaqësuar nga z. Taulant Bino u shpreh se ligji i vitit 2017 është relativisht i mirë dhe respekton në frymë të përgjithshme parimet për mbrojtjen e natyrës. Në këtë frymë duhet që edhe çdo lloj ndryshimi që mund të vijë nuk duhet të ndryshojë frymën e ligjit. Konkretisht, ndërhyrjet e propozuara duhet të mbështetet në vlerat natyrore që ato mbrojnë dhe shërbimet mjedisore e shëndetësore që ato ofrojnë për të ofruar më shumë mbrojtje dhe më shumë shërbime mjedisore. Këto ndryshime duhet të respektojnë proceset e planifikimit dhe vendimmarrjet e mëparshme planifikuese përfshirë miratimin e kufijve dhe zonimin nga KKT dhe Këshilli i Ministrave, planin kombëtar vendor, planin e përgjithshëm vendor dhe planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Po kështu, zonat e mbrojtura me qëllim mbrojtjen e larmisë biologjike dhe natyrore të natyrore nuk duhet të shihen thjesht dhe vetëm si zona ekonomike në

brendësinë dhe zemrën e të cilave mund të zhvillohet çdo lloj aktiviteti ekonomik i paqëndrueshëm dhe i papranueshëm për ruajtjen e integritetit ekologjik të tyre, habitateve natyrore dhe specieve të faunës dhe florës së egër që ato strehojnë.

Projektligji i propozuar ka nevojë për këshillime e diskutime, të cilat duhet të marrin kohën e vet. Për këtë arsye kemi kërkuar që data e shqyrtimit të tij në seancë plenarë të shtyhet sepse nevojitet kohë që të bëhen diskutimet e nevojshme e të duhura, që ne të japim një ligj të përmirësuar.

Shqetësimet konkrete për projektligjin lidhen me:

- Nenin 2, i cili duket se paraqet një lloj konfuzioni. Ndryshimi i tij duket sikur u lë dorë të lirë për të vendosur për aktivitetet, të cilat i ka ndaluar vetë ligji, në pikat “a”, “b” dhe “c”. Është mirë që ky lloj konfuzioni të shmanget.
- Nenin 4, që flet për aksesin e publikut në zonat e mbrojtura. Ky nen sjell keqkuptim në çështjet e aksesit të publikut, kërkon ti kthejë ZM-të në “lulishte bashkiake” me akses për të gjithë dhe mohon qëllimin e regjimit të nënzonimit e sidomos të Nënzonës Qëndrore.
- nenin 6, lidhur me të drejtën e administrimit nga bashkia të jo më pak se 20% të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. Dhënia e të drejtës për menaxhimin e 20% të sipërfaqes të një ZM bashkive krijon precedentin e rrezikshëm të disa trupave menaxhuese për të njëjtën ZM, krijon konflikt institucional dhe çon në shkatërrimin e ZM-së;
- nenin 7, që ndryshon nenin 9 të ligjit, lidhur me objektivat e shpalljes së territoreve zona të mbrojtura. Këto ndryshime duket sikur lejojnë zhvillimin e veprimtarive intensive njerëzore brenda zonave të mbrojtura dhe të ndërtimit të zonave urbane, autostradave etj. (heqja e pikave “ç” dhe “e”). Po kështu edhe formulimi i pikës d” që shtohet duhet të rishikohet, pasi në mënyrën si është formuluar krijon përshtypjen se në zonat e mbrojtura mund të ndërtohen zona urbane, rekreacioni, infrastrukturë rrugore, hekurudha, infrastrukture energjetike, përfshirë impiantet për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, infrastrukturës së naftës dhe gazit. Prandaj ky nen duhet të rishikohet edhe në aspektin e përputhshmërisë me edhe me dy direktiva bazë në fushën e mbrojtjes së natyrës: direktivën e shpendëve dhe direktivën e habitateve;
- nenin 10, ku ka nevojë për disa riformulime, pasi shtesa në germën “c” të pikës 2 të Nenit 16 “Park Kombëtar” i lë dorë të lirë KKT-së për të vendosur edhe për aktivitete të ndaluara nga pikat a, b, dhe c. Germa “d” ka nevojë për ndryshim duke i shtuar përpara fjalën “ndalohe”. Edhe heqja e zonës buferike e cila ul mundësinë e kontrollit të aktiviteteve dëmtuese përreth dhe pranë Monumentit të Natyrës duhet të rishikohet pasi zona buferike nuk është detyruesisht ndaluese për çdo lloj aktiviteti, referuar përkufizimit të saj në ligjin aktual;
- nenin 19, i cili i hap rrugë rishikimit të shpeshtë të planit të menaxhimit, duke e ndryshuar atë sa herë që institucionet kanë nevojë. Planet e menaxhimit, si dokumente themelore të menaxhimit të një zone të mbrojtur, të parashikohen në mënyrë periodike dhe jo sa herë të shfaqet mundësia, sepse kjo do t’i bëjë ato të paqëndrueshme dhe, për

pasojë, të pazbatueshme. Ne jemi për rishikimin e planit të menaxhimit, jo për rishikime të shpeshta të tij, por që të mund të legjitimoheshin një herë në pesë vjet, nëpërmjet urdhrit përkatës të ministrit “Për miratimin e strukturës së standardizuar të planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur” dhe nenit 42 “Hartimi dhe miratimi i planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur”.

2. Qendra “Shpendët e Shqipërisë”

Qendra “Shpendët e Shqipërisë”, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, z. Mirjan Topi, u shpreh se ligji i aktual “Për zonat e mbrojtura”, si dhe instrumentet ligjore ekzistuese për menaxhimin e zonave të mbrojtura janë të duhurat për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura nëse do të kenë një zbatueshmëri të plotë ose së paku më të mirë. Çdo propozim i mundshëm për ndryshimin e këtij ligji duhet të vijë vetëm pas një analize të thelluar të zbatueshmërisë së ligjit aktual dhe evidentimit të nevojave faktike për ndryshimin e ligjit, gjithmonë pa cenuar parimet bazë të qëllimit dhe funksionalitetit të zonave të mbrojtura, si dhe pas një procesi konsultimi shumë të gjerë dhe gjithëpërfshirës me palët e interesit dhe me ekspertët e ruajtjes së natyrës në vend. Për këtë qëllim projektligji duhet të rishikohet në tërësi në mënyrë që të shmangë rrezikun e:

- Lejimit të ndërtimit të veprave të mëdha infrastrukturore si hidroelektrocentralet, nxjerrja e hidrokarbureve, etj., brenda territorit të ZM;
- Cenimit të qeverisjes së mirë dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura në Shqipëri;
- Cenimit të interesit kombëtar që ekziston për ruajtjen e hapësirave me vlera të larta natyrore nga zhvendosja e kompetencave menaxhuese në varësi të interesit të çdo bashkie;
- Mbivendosjes me dispozitat ekzistuese dhe krijimit të hapësirës për paqartësi dhe keqinterpretim të dispozitës së ligjit.

Qendra “Shpendët e Shqipërisë” ka bërë komente specifike për nenet 1,6,7 dhe 9 të projektligjit.

3. Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

Në cilësinë e përfaqësuesit të kësaj qendre, z. Aleksander Trajçe dhe z. Zydjon Vorpsi u shprehën se Ligji aktual për zonat e mbrojtura i ka të gjitha mekanizmat dhe strukturat e përfshirjes së komunitetit, parashikon hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, ku komuniteti është i përfaqësuar shumë mirë; parashikon ngritjen dhe funksionimin e komiteteve të menaxhimit, ku serish komuniteti është i përfaqësuar shumë mirë, ku edhe bashkitë respektive kanë anëtarë në këto komitete dhe ne duhet të kemi një analizë shumë të thelluar të zbatimit të ligjit aktual përpara se të kalojmë në diskutime për nevojat për ndryshim.

Ndërhyrjet e propozuara paraqesin disa pasaktësi të cilat mund të hapin rrugën ndaj zhvillimit të paqëndrueshëm në Zonat e Mbrojtura dhe të cenojnë sistemin e zonimit të zonave (psh. propozimi për heqjen e nenit 13 të ligjit).

Për këtë arsye vlerësohet se projektligji ka nevojë për shumë ndërhyrje, ndaj ritheksojmë nevojën për dëgjesa publike me palët e shumta të interesit, organizatat mjedisore, institucionet kërkimore dhe akademike dhe ekspertë të fushës së ruajtjes së natyrës përpara çdo lloj progresi me këto ndryshime të propozuara. Do të ishim shumë të gatshëm të shprehim mendimet tona edhe mbi draftin e përmirësuar të projektligjit.

4. Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)

Përfaqësuesi i saj, z. Olsi Nika u shpreh se pas shqyrtimit me shumë kujdes dhe profesionalizëm të propozimeve për amendimet e sjella nga grupi deputetëve vlerësojmë se arsyet e shpallura dhe të thëna nga nismëtarët për këto ndryshime në relacionin përkatës, ligji aktual nuk i anashkalon, sidomos për zonat që kanë më shumë shtrirje në territor. Duke përjashtuar kategorinë e parë dhe kategorinë e tretë, që është “monumenti i natyrës”, të tjerat patjetër që janë zonat që kanë shtrirje në territor dhe është zbatimi më i mirë i standardeve të IUCN-së, ku 75% i lihet natyrës, është zona qendrore dhe pastaj 25% njeriu mund të ndërveprojë me to.

Ne jemi dakord me shqetësimet për sa i përket menaxhimit të zonave të mbrojtura, çfarë përfitojnë bashkitë, çfarë përfiton ekonomia lokale, çfarë përfitojmë ne të gjithë si ekonomi nga këto zona, pasi janë shqetësime që edhe ne i vërejmë ne terren, por këto mund të zgjidhen edhe me menaxhimin efektiv në terren të zonave të mbrojtura.

Problematikat konkrete që vlerësojmë se duhet të rishikohen në projektligj janë:

- harmonizimi mes neneve të ndryshme dhe konfuzioni institucional në raport me tagrat dhe kompetencat e autoriteteve përgjegjëse për politikëbërjen dhe atyre të menaxhimit dhe administrimit të këtyre territoreve. Orvatja për t'i dhënë më shumë kompetenca Bashkive në “administrimin” e Zonave të Mbrojtura, duke ja marrë ato institucioneve të specializuara siç është AKZM, në një kohë që kapacitetet e Bashkive janë thellësisht të limituara të përmbushin edhe ato që kanë aktualisht, të çon te heqja dorë nga qeverisja dhe përfundon me administrimin e këtyre zonave nga subjektet private që në themel të funksionit të tyre kanë maksimizimin e fitimit dhe konservimin e natyrës;
- qartësimi i konceptit të zonës buferike, pra cila është, cila nuk është, ku shtrihet, a shtrihet përtej zonës së jashtme e të tjera;
- qartësimi i 20%-t të administrimit nga bashkitë, i cili mund të jetë kuptuar dhe shprehur gabim, pasi zonat e mbrojtura nuk mund të ndahen me 20%, sepse një ndër parimet bazë për to është integriteti ekologjik i tyre, ndaj ato shihen si një e tërë dhe menaxhohen si një e tërë.

Me qëllim përmirësimit të projektligjit bëhen komente dhe propozohen riformulime konkrete në nenet 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,19, 20.

5. Instituti për ruajtjen e natyrës në Shqipëri (INCA)

Përfaqësuesi i tij, z. Genti Kromidha, u shpreh se INCA mendon se ndryshimet e propozuara prekin frymën e ligjit “Për zonat e mbrojtura”, në tre çështje kryesore që ai trajton. Konkretisht:

1. Neni 7, i cili propozon ndryshime në nenin 9 të ligjit, rrit mundësitë për ndërhyrje brenda zonës së mbrojtur, pa u kufizuar në zonat urbane, rekreacionin, infrastrukturën rrugore, hekurudhat, infrastrukturën energjetike (përfshirë strukturat e energjisë së rinovueshme), Infrastruktura e naftës dhe gazit." Zonat e mbrojtura nuk janë ngritur me qëllim lejimin e ndërhyrjeve siç u përmend më sipër. Kjo shtesë do të çonte të hapjen e zonave të mbrojtura për ndonjë nga projektet e zhvillimit të përmendura më sipër.
2. Propozimi për shfuqizimin e nenit 13 të ligjit ekzistues që përcakton zonimin e zonës së mbrojtur vjen ndesh me përvojën afatgjatë të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Zonimi i zonave të mbrojtura është një mjet i rëndësishëm menaxhimi që mundëson ruajtjen e vlerave kryesore natyrore, ndërsa krijon hapësirë për të vazhduar aktivitetet socio-ekonomike të komuniteteve lokale.
3. Neni 6, që propozon disa ndryshime në nenin 8 të ligjit ekzistues, sipas të cilit bashkive u lejohej të marrin në menaxhim të paktën 20% të territorit të zonave të mbrojtura. Dhënia e të drejtës për menaxhimin e 20% të sipërfaqes të një zone të mbrojtur bashkive hap rrugën për konflikte përgjegjësish, pasi detyrat dhe përgjegjësitë e bashkisë janë qartësisht të caktuara në ligjin e tyre organik dhe zbatojnë kërkesat e këtij ligji për ZM ku gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre bashkëpunojnë me administratën rajonale të zonave të mbrojtura dhe me administratën e zonave përkatëse.

INCA ka bërë komente specifike me natyrë teknike për nenet 1,2,3,4,6,7,8,10,12,15,19,20,21.

6. Qendra Burimore e Mjedisit- REC

Përfaqësuesi i REC, z. Mihallaq Qirjo, u shpreh se shqetësimet lidhur me këtë projektligj lidhen kryesisht me:

- shpejtësinë e sjelljes së këtij diskutimi në tavolinë dhe shpejtësia me të cilën po bëhen ndryshimet nuk na lë mundësinë të diskutojmë teknikisht për t'i sjellë interesat e ndryshme në të njëjtën tavolinë.
- faktin që procesi që ka ndodhur disa vite më parë me zonimin, të cilin edhe atëherë e kemi vlerësuar si të nevojshëm, por për shkak të shpejtësisë me të cilën u bë, la jashtë disa zona, që mendojmë se nuk duhet të ishin lënë jashtë zonave të mbrojtura.

- faktin se ligji ekzistues i vitit 2017 i jep mundësi reale për menaxhimin e zonave të mbrojtura nivelit vendor, por edhe nivelit të prefektëve, të cilët janë anëtarë të këshillave të zonave të mbrojtura, por kanë treguar një pjesëmarrje shumë të vakët në rolin e tyre.
- faktin se ndryshimet që propozohen krijojnë një precedent shumë të rrezikshëm për zonat e mbrojtura, kur thuhet se nëse vlerësohet që një zonë e mbrojtur nuk plotëson objektivat që ajo ka, mund të ndryshojë kategorizimi.
- faktin se cenohet direktiva e habitateve.

7. Qendra mjedisore “Eden”

Përfaqësuesja e saj, znj. Ermelinda Mahmutaj, u shpreh se projektligji është një nismë për të rritur ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërinstytucional për zonat e mbrojtura dhe thekson nevojën për ndërveprim institucional. Vlerësojmë faktin që bashkitë kërkojnë të forcojnë kompetencat dhe veprimtaritë e tyre dhe do të ishte akoma më mirë nëse do të tentonin ta bënë këtë gjë edhe në ato zona që i administrojnë 100%, pra, të shikojnë si mund të përmirësojnë performancën, si mund të përfitojnë më shumë dhe më mirë në zonat ku i kanë 100% kompetencat e tyre, dhe të rrisnin vendimmarrjen, që ligji aktual ua lejon, por që duhet të shfaqet më mirë deri në çfarë mase dhe ku janë problemet.

Vlerësojmë faktin që ky projektligj e thekson vazhdimisht se nuk synon ndryshimin e qëllimit dhe funksionimit të zonave të mbrojtura, pavarësisht gjuhës jo teknike që është përdorur, qoftë nga pikëpamja ligjore, qoftë nga pikëpamja e fushës së mjedisit.

Shqetësimi i grupit propozues apo i bashkive të vendit lidhur me mungesën e koordinimit, të bashkëpunimit dhe në disa raste edhe mungesën e përfitimit ekonomik nga këto asete që ato kanë në zonat që administrojnë, është një shqetësim madhor i cili vlen të ngrihet dhe të adresohet, por nuk e dimë nëse një ndryshim bazik ligjor mund të jetë zgjidhja më e mirë për të adresuar shqetësimin e bashkive. Një tryezë ndërveprimi dhe komunikimi ndërinstytucional me aktorët që punojnë në sektorin e mjedisit, me institucionet që kanë tashmë kompetencat dhe bashkitë, për të parë dhe analizuar ku qëndron njëra dhe tjetra ndoshta do të ishte një përjasje më e maturuar dhe më e pjekur e një shteti demokratik.

Shqetësimet e “Qendrës Eden” lidhur me projektligjin e propozuar lidhen konkretisht me:

- dy parime, parimin e përshtatshmërisë dhe parimin e fleksibilitetit, të cilat janë një fjalor i përdorur nga IUCN-ja dhe nënkuptojnë përshtatjen e formave të ruajtjes dhe të menaxhimit të zonave të mbrojtura, me qëllim që ato të mos zbresin nga kategoria ekzistuese, por vetëm të rriten. Këto janë parime që përdoren kryesisht në planet e menaxhimit dhe jo në nivele ligjore. Projektligji i propozuar paraqet një keqinterpretim apo moskuptim të qartë të tyre.
- paqartësitë që paraqet në ripërcaktimin dhe shpërndarjen e kompetencave për menaxhimin dhe administrimin e zonave të mbrojtura, konkretisht duke i dhënë Këshillit

të Ministrave kompetenca të vazhdueshme, deri në teknike, pavarësisht se Këshilli i Ministrave është organ kolegjal shumë i lartë dhe ka kompetenca vendimmarrëse të larta.

- anashkalimin e të drejtave që kanë bashkitë për menaxhimin e zonave të mbrojtura me ligjin aktual, pa bërë një analizë pse bashkitë nuk po gëzojnë nga këto të drejta, siç shprehen, dhe ku qëndrojnë problematikat.

8. Organizata “Iliria”

Përfaqësuesi i saj, z. Abdulla Diku, u shpreh se Ligji aktual i zonave të mbrojtura, i hartuar në konsultim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në një proces të gjatë konsultimesh e diskutimesh, përmban udhëzimet e IUCN-së dhe direktivën kuadër të BE-së për mbrojtjen e habitateve. Edhe pse ky ligj nuk është 100% i përafuar me legjislacionin europian, ka bazë të madhe nga ky legjislacion, nga direktivat, nga konventat ku Shqipëria është pjesë. Prandaj gjykojmë se përpara se të ndërmerreshin hapa për ndryshimin tij do të duhej të ishte bërë një analizë teknike, ligjore, socio-ekonomike se çfarë nuk shkon me ligjin, i cili ka vetëm 6 vjet që është miratuar, pra nuk është një ligj i vjetër. Propozimet për ndryshime në këtë ligj duket se e zhbëjnë këtë dhe sjellin njëfarë regresi.

Problematikat kryesore që evidentojmë janë ato të kontradiktave midis neneve, zhbërja e elementit të zonimit, respektimi i detyrimeve në kuadër të dokumenteve strategjike evropiane ku Shqipëria është pjesë, etj.

Organizata “Iliria” ka bërë komente specifike për nenet 1,7,9,10,13,20 të projektligjit.

9. “Instituti për Zhvillimin e Habitaveve”- Co-Plan

Përfaqësuesi i institutit, z. Erni Kocani, u shpreh se e shikojmë me shumë vlerë këtë diskutim që zhvillohet sot dhe vetë fakti që ju keni pranuar prezencën tonë dhe të kolegëve të tjerë nëpër dëgjesa të tjera, tregon vullnetin tuaj të mirë për të bërë një diskutim gjithëpërfshirës.

Shqetësimi ynë lidhet me kompetencat e administrimit të ZM, të cilat sipas propozimit do t'i kalojnë bashkive në 20% të territorit të tyre. Nëse nëpërmjet këtij projektligji, do të bëjmë një fragmentarizim, ku secila bashki menaxhon 20%-shin e saj brenda territorit të saj, të zonës së mbrojtur, mund të fragmentojmë një zonë që ka nevojë për një qasje apo për një menaxhim rajonal, në disa raste, edhe kombëtar. Për t'u diskutuar janë edhe kapacitetet e bashkive për të menaxhuar zonat e mbrojtura dhe për këtë duhet të bëhet një vlerësim nëse ato i kanë apo jo këto kapacitete. Ne e shikojmë zonën e mbrojtur si një ekosistem që funksionon si një i tërë për sa i takon si faunës, ashtu edhe florës. Perceptimi që ka secili prej ekspertëve të fushës apo personat e përfshirë është që menaxhimi nuk duhet të jetë vetëm lokal, por duhet të jetë rajonal dhe kombëtar, në varësi të interesit për secilën nga këto zona.

10. Shoqata e bujqësisë organike

Përfaqësuesi i saj, z. Lavdosh Feruni, u shpreh se shqetësimi kryesor i shoqatës është shpejtësia e shqyrtimit të projektligjit. Projektligji ka nevojë të rishikohet nën për nen dhe për këtë arsye do të duhet të marrë kohën e mjaftueshme dhe të ketë një diskutim të gjerë.

Znj. Xhevahire Dulja u shpreh se problemi më i rëndësishëm që paraqet projektligji është 20%-shi që mendohet të menaxhohet nga bashkitë dhe pushteti lokal, që ngre ato pikëpyetje që u përmendën edhe nga kolegët.

Në përgjigje të shqetësimeve të prezantuara nga përfaqësuesit e grupeve të interesit, z. Fadil Nasufi, në emër të grupit të deputetëve propozues të projektligjit, u shpreh se në biem dakord që ligji ka nevojë për amendime në të gjithë përmbajtjen e vet, si dhe kërkon një rishikim tërësor, i cili nuk duhet të anashkalojë ekspertizën profesionale. Ligji aktual është shumë konservator dhe duhet t'u japim përgjigje disa shqetësimeve reale, me të cilat përballemi, në harmonizimin e të gjithë legjislacionit shqiptar dhe në harmonizimin e të gjitha projekteve që ka vendi për zhvillim.

Në thelb duhet ta kemi të qartë se ky projektligj nuk synon të prekë kufijtë e zonave të mbrojtura, nuk ka si qëllim t'i tjetërsojë ato për qëllime të tjera, apo të lërë shteg për interpretime dhe spekulime, që të ketë një qasje agresive për urbanizimin e tyre dhe tjetërsimin e funksionit të tyre, ku prevalon mbrojtja e natyrës dhe të qenit korrektë me legjislacionin europian dhe IUCN-në.

Unë paraprakisht dua t'ju falënderoj, se ju nuk keni bërë vetëm mohime në komentet tuaja, apo kundërshtim të plotë, absolut, por keni bërë edhe qasje, edhe komente, që lidhen me rishikimin, me saktësimin e përkufizimeve, me mospërsëritjen e neneve, me saktësimin e formës së kombinuar të menaxhimit dhe të administrimit të zonave të mbrojtura, me rolin politikëbërës, që nuk duhet ta ketë Këshilli i Ministrave, por Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, me sqarimin e terminologjisë, me raportet për problematikat që duhet të ketë bashkia, ku shtrihet zona e mbrojtur, dhe autoritetet qendrore, siç janë institucionet përkatëse që merren në mënyrë profesionale me zonat e mbrojtura, si dhe me specifikimet, që kanë të bëjnë me planet e menaxhimit dhe me qartësimin e terminologjive, të cilat meritojnë një vëmendje dhe një qasje më të orientuar drejt profesionalizmit tuaj.

Në duhet ta kemi të përbashkët shqetësimin, që të bëhet një harmonizim midis ligjit për zonat me përparësi zhvillimi, që janë prioritet kombëtare, dhe zonave të mbrojtura për të shmangur mbivendosjet dhe për të zhbllokuar shumë probleme të mbartura dhe të ngurtësuara, të cilat lidhen me atë që ka ndodhur ndër vite, pra me preken dhe informalitetin që kanë këto zona të mbrojtura. Domethënë, do të shikojmë si janë sot realisht hartat ekzistuese, informaliteti, ndërtimet në to, si dhe nevojat që kanë zonat e mbrojtura për të ofruar shërbime të kontrolluara për qëllime turistike, për agrobiznes për të garantuar mbrojtjen e zonave të mbrojtura me instrumente, me infrastrukturë dhe logjistikë.

Në gjykimin tim, pa dyshim, nuk do të kenë përparësi problemet e urbanizimit apo thjesht kriteri ekonomik, pasi prevalon çështja e mbrojtjes së natyrës, por ne duhet të gjejmë mekanizmat ligjorë që edhe marrëdhënia, apo qasja që ka turizmi ndaj natyrës duhet të mos jenë të bllokuara në një ngërç ligjor.

Ndërkohë, ne kemi edhe zona të mbrojtura që në proces e sipër të tranzicionit kanë tjetërsuar funksionin e tyre ose janë uzurpuar me informalitet, ose territoret përkatëse si Divjaka, që janë urbanizuar, apo Pogradeci, që e ka pothuajse të gjithë territorin e vet zonë të mbrojtur, pra të mos e lëmë bashkinë me duar të lidhura përballë problemeve për t'u shërbyer komunitetit dhe programeve të tyre të zhvillimit.

Në këtë kuadër, vlerësoj se komentet dhe sugjerimet tuaja janë shumë të vlefshme dhe i shërbejnë mundësimit të përmirësimeve në tekstin e projektligjit, me qëllim që në përfundim të procesit të miratojmë një ligji funksional, që të jetë në harmoni me direktivat europiane dhe IUCN-në, dhe një ligji që i harmonizon të gjitha problematikat e tjera të zhvillimit të turizmit, të mbrojtjes së natyrës dhe të qasjes së të gjitha politikave tona ndaj natyrës, duke faktorizuar edhe pushtetin vendor, por më me peshë në çështjet e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Kryetari i komisionit u shpreh se është me rëndësi të theksohet dhe të kuptohet se qëllimi i propozimit për ndryshime në ligjin aktual nuk ka të bëjë me thelbin e ligjit, por ka të bëjë me zgjidhjen e disa problematikave, që kemi qoftë për ndërtime apo për gjëra të cilat ne tashmë i kemi trashëguar në këto zona, që duhet të marrin drejtim, qoftë edhe një problem të madh që kemi aktualisht me shpopullimin, i cili po na vjen nga këto zona me largimin e njerëzve, pikërisht sepse nuk mund të përfshihen në çdo lloj aktiviteti, sado minimal, në pronat e tyre, të cilat mund t'i kenë brenda këtyre zonave të mbrojtura.

Sigurisht, nga debatet që bëjmë me njëri-tjetrin shpresojmë të prodhojmë një produkt, që realisht të ndërthurë sa më mirë interesat e të gjitha palëve. Është e pamundur të arrijmë konsensusin për 100% të gjërave, por besoj se do të arrijmë në një produkt të mirë nëse do të ndërthurim sa më shumë interesa midis shoqërisë civile, banorëve, bashkive, qeverisë qendrore dhe Kuvendit.

E rëndësishme është që vullneti ynë për mbrojtjen e natyrës apo për zonat e mbrojtura në veçanti ka qenë i shprehur, dhe është shprehur së fundi edhe në shpalljen e Vjosës Park Kombëtar. Ne luftojmë fort, madje kini parasysht që një pjesë e mirë e anëtarëve të këtij komisioni janë dhe pjesë e grupit joformal të gjelbër të Kuvendit të Shqipërisë, kështu që ne jemi shumë të vëmendshëm ndaj të gjitha ndryshimeve që bëhen në lidhje me këtë çështje. Si ligjvënës, ne jemi të detyruar të gjejmë disa zgjidhje, por qëllimi i kësaj mazhorance nuk është të heqë dorë nga politika e saj, qoftë për zonat e mbrojtura, qoftë në përgjithësi për luftën e madhe, jo thjesht në Shqipëri, por në përgjithësi si shoqëri, që duhet të bëjmë ndaj ndryshimeve klimatike, nga të cilat nuk shpëton as Shqipëria, meqë jemi të gjithë të prekur. Sigurisht, zonat e prekura janë një nga elementet bazë në këtë luftë që jemi duke zhvilluar. Para pak muajsh Shqipëria është anëtarësuar në Unionin Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN). Sigurisht, kjo e obligon Shqipërinë

që të zbatohet disa parime për të cilat flasin të gjithë. Për këto arsye nuk duhet të vihet në diskutim qëllimi, vizioni dhe përkushtimi i kësaj mazhorance për zonat e mbrojtura apo lufta jonë ndaj ndryshimeve klimatike.

Kemi rënë dakord parimisht që projektligji ka nevojë për riformulime në një pjesë të konsiderueshme të tij, me qëllim që të adresohen një sërë problematikash të evidentuara edhe nga këto seanca dëgjimore të zhvilluara me intensitet në komision. Për shembull, personalisht e kam thënë që edhe unë nuk jam dakord me 20%-shin në këtë formë, pra në ndarje territori. Jam dakord që bashkitë të marrin një të ardhur nga zonat e mbrojtura, sepse janë në territorit e tyre dhe ato duhet t'i shfrytëzojnë, por jo në formën e territorit, sepse edhe unë besoj që dy entitete që kontrollojnë të njëjtën gjë i prishin punë njëra-tjetrës.

Kolegët tanë, duke u nisur nga ajo që kanë kërkuar kryetarët e bashkive, kanë bërë këto propozime, por këto propozime nuk janë përfundimtare. Ne prandaj po e zhvillojmë të gjithë këtë proces, prandaj ka këto lloj procedurash aprovimi i një projektligji, që në produktin final të merren parasysh sa më shumë gjëra. Ajo që mund të themi, që e kemi thënë vazhdimisht, është se nuk është qëllimi të ndërrojmë esencën e ligjit të zonave të mbrojtura, por ta përmirësojmë dhe ta bëjmë më efektiv.

➤ **Komente/sugjerime të përfaqësuesve të grupeve të interesit të adresuara në tekstin e projektligjit**

Në përfundim të një procesi të gjerë konsultimi, pasi administroi, shqyrtoi dhe trajtoi komentet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të grupeve të interesit, Komisioni për veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës për projektligjin adresoi shqetësimet/komentet dhe vërejtjet sa më poshtë vijon:

1. Nuk janë marrë në konsideratë komentet e grupeve të interesit për nenin 1 të projektligjit, pasi vlerësohet i rëndësishëm shtimi i numrit të parimeve ku bazohet puna për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura, bazuar në Udhërrëfyesin e IUCN-së, një nga dokumentet ndërkombëtare më prestigjioze për menaxhimin e zonave të mbrojtura, aderimi i RSH në të cilin u miratua nga Kuvendi në janar 2024.
2. Pranohen komentet për nenin 2 të projektligjit, duke e hequr si nen.
3. Pranohen komentet për nenin 3 të projektligjit duke e hequr si nen, pasi vlerësohet se në ligjin aktual janë të parashikuara kompetencat dhe funksionet e institucioneve shtetërore për mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura.
4. Pranohen komentet për nenin 4 duke e hequr si nen, pasi vlerësohet se ligji aktual e rregullon edhe aktivitetin e vizitueshmërisë së zonave të mbrojtura.

5. Pranohen komentet për nenin 5, duke e hequr si nen, pasi vlerësohet se në klasifikimet e zonave të mbrojtura në ligjin aktual janë edhe parqet bashkiake.
6. Pranohen komentet për nenin 6, duke e hequr si nen, pasi vlerësohet se ky nen fragmentarizon zonat e mbrojtura në Shqipëri, të cilat krijohen për të ruajtur vlerat natyrore me rëndësi kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe për këtë arsye menaxhohen nga AKZM. Për zonat me rëndësi lokale të ruajtjes së vlerave natyrore, bashkitë mund të krijojnë dhe të menaxhojnë “Parqet bashkiake” ose “Kurorat e gjelbra”, siç përcaktohet tashmë nga ligji ekzistues për zonat e mbrojtura.
7. Janë adresuar një pjesë e komenteve për nenin 7, duke e riformuluar atë. Me qëllimin që të përcaktohen qartë objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura, bazuar te parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, tashmë riformulohen vetëm shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të dispozitës në fuqi.
8. Janë adresuar komentet për nenin 8, duke e riformuluar si nen. Vlerësohet se qëllimi i propozuesve, i cili lidhet ngushtësisht me përfitimet e komunitetit lokal që jeton në zonat e mbrojtura, është i drejtë, por në formën e propozuar nuk reflekton kuadrin më të gjerë socio-ekonomik të këtij procesi.
9. Nuk pranohen komentet për nenin 9 pasi vlerësohet se është e rëndësishme të aplikohen rregullat e zonimit dhe nënzonimit dhe shkalla e mbrojtjes përkatëse në mënyrë që të kemi një ndarje të qartë të klasifikimit të zonave të mbrojtura, duke marrë parasysh edhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm për komunitetin lokal dhe zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Është e rëndësishme të kuptohet që zonimi dhe nënzonimi nuk janë elemente thelbësore të procedurës së mbrojtjes së zonës së mbrojtur, por elemente tekniko - formale të kësaj procedure. Prandaj, me qëllim për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave në fuqi mbi zonimin nevojitet të bëhen disa përshtatje ligjore në tekstin e projektligjit.
10. Janë adresuar shqetësimet dhe komentet për nenin 10, duke e riformuluar atë, pasi vlerësohet se propozimi nuk është i saktë dhe nuk reflekton mënyrën e konservimit, mbrojtjes dhe menaxhimit të një Parku Kombëtar, pasi: propozimi për liberalizimin e rregullave për ndërhyrjet në Parkun Kombëtar cenon objektivat e mbrojtjes për të cilat shpallet një park kombëtar; përdorimi i termit të veprimtarive ekonomike duke mos e kufizuar atë në fusha veprimi apo aktivitete të caktuara japin miratim dhe për ndërtimin e hekurudhave, hidrocentraleve dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë.

11. Nuk pranohet komenti për nenin 11, pasi vlerësohet se propozimi për ndryshimin e nenit 17 është i nevojshëm pasi parashikimi ligjor ekzistues nuk është në harmoni me udhëzuesin ndërkombëtar të IUCN për të shpallur një zonë të mbrojtur dhe nuk reflekton plotësisht kategorinë III për të cilën shpallet. Një monument natyre nuk mund të jetë i barabartë me Rezervën Strikte, kategoria I, pasi parimet dhe karakteristikat e shpalljes së tij janë tërësisht të ndryshme nga këto. Megjithatë, ky nen do të riformulohet nga komisioni me qëllim saktësimin e përmbajtjes së tij.
12. Janë adresuar komentet për nenin 12, duke e riformuluar atë. Vlerësohet se ndryshimet që propozohen në Rezervatin Natyror të Menaxhuar/Park Natyror” sa i takon shfrytëzimit dhe zënies së zonës me aktivitete të cilat bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje, duhet të përshtaten në teknikë legjislative dhe logjike aplikimi me nenin 16 të ligjit nr.81/2017 që lidhet me kategorinë II, duke ruajtur karakteristikat e kategorisë IV. Kjo do të sjellë një zbatim të qartë të këtij neni në shpalljen e zonave të mbrojtura, përdorimin e aktit ligjor për secilin park natyror/ rezervat natyror të menaxhuar.
13. Janë adresuar komentet për nenin 13, i cili propozon ndryshime në kategorinë V të mbrojtjes (neni 20 i ligjit) që është Peizazhi i Mbrojtur, duke lejuar ndërhyrjet urbane, të rekreacionit dhe industriale si dhe zhvillimin e aktiviteteve me fokus zhvillimin ekonomik të zonës. Vlerësohet se propozimi vjen si rrjedhojë e tipologjisë së kategorisë së mbrojtur, e cila, bazuar në referimin e udhëzuesit të IUCN përcaktohet si “Një zonë e mbrojtur ku ndërveprimi i njerëzve dhe natyrës me kalimin e kohës ka prodhuar një zonë me karakter të veçantë me vlera të rëndësishme ekologjike, biologjike, kulturore dhe skenike. Kategoria V nuk i jep përparësi kërkimit, megjithëse mund të ofrojë mundësi për të studiuar ndërveprimet midis njerëzve dhe natyrës. Kategoria V përfshin opsionin e ndërveprimit të vazhdueshëm njerëzor. Zonat e mbrojtura të kategorisë V nuk janë "shkretëtira" siç përcaktohet nga IUCN. Duke u bazuar te këto parime si dhe në unifikimin e praktikës ligjore me kategoritë e sipërmendura sa i takon shpalljes dhe caktimit të rregullave të ruajtjes, mbrojtjes dhe menaxhimit, ky nen do të riformulohet nga komisioni.
14. Pranohen komentet për nenin 14, duke e hequr si nen. Vlerësohet se amendimi i nenit 21 të ligjit në fuqi është i panevojshëm, pasi planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi hartohen nga AKZM-ja dhe miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura. Secila zonë e mbrojtur në Republikën e Shqipërisë duhet të ketë aktin ligjor të dedikuar.
15. Pranohen komentet për riformulimin e neneve 15-17, të cilat propozojnë një qasje të unifikuar të përcaktimit të veprimtarive duke lënë një liri propozimi dhe veprimi në

planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, përveç atyre të përcaktuara në nenet 33 dhe 34. Planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi hartohen nga AKZM-ja dhe miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura.

16. Janë adresuar shqetësimet për nenin 18, i cili propozon shtesa të veprimtaritë e lejuara, duke e riformuluar atë. Me qëllim për të pasur qartësi në veprimtaritë e lejuara *ex lege*, ky nen nevojitet të riformulohet i gjithi, në frymën e propozimit integral të të gjitha neneve të projektligjit.

17. Pranohen komentet për nenet 19-20, të cilët konsistojnë në krijimin e mundësive për rishikimin e planit të menaxhimit nga AKZM-ja, mbështetur në parimin e përshtatshmërisë dhe nevojës për rishikimin e planit të menaxhimit. Neni 19 dhe 20 hiqen nga projektligji, pasi vlerësohet se adresimi i këtyre rregullimeve duhet të gjejë garanci më të plotë me ndryshime në disa nene të tjera në tekstin e ligjit nr.81/2017.

18. Pranohet komenti për nenin 21 , duke e riformuluar.

- ***Institucionet zbatuese***

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë, Ministria përgjegjëse për mjedisin, AKZM dhe ADZM-të, si dhe Njësitë e veteqeverisjes vendore.

- ***Efektet financiare të aktit***

Referuar dokumenteve që shoqërojnë projektligjin rezulton se nuk ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Prezantimi i nismës “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në emër të deputetëve që kanë ndërmarrë nismën ligjore, u bë nga z. Fadil Nasufi.

Në fjalën e tij z. Nasufi u shpreh se ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” u ndërmorën në përgjigje të një letre drejtuar Kuvendit të Shqipërisë nga kryetarët e bashkive të Shkodrës, të Lezhës, të Himarës, të Vlorës, të Elbasanit, të Korçës, të Librazhdit, të Gjirokastrës, të Përmetit, Të Fierit, të Durrësit, të Malësisë së Madhe, të Cërrikut, të Burrelit dhe të Sarandës, të cilët ngrenë shqetësimin dhe kërkojnë marrjen në konsideratë të ndryshimit të kuadrit ligjor të zonave të mbrojtura, pasi është një ligj i ngurtë, shumë konservator dhe praktikisht i pazbatueshëm në disa elemente të tij dhe që e privon qeverisjen vendore në

mundësinë e administrimit të zonave të mbrojtura për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, për përfitimin nga komuniteti lokal të kësaj pasurie dhe për aksesin që duhet të ketë pushteti vendor mbi zonat e mbrojtura.

Republika e Shqipërisë, me shpalljet dhe vendimet e marra ndër vite, ka 21,4% të territorit të saj “zonë të mbrojtur”, ku përfshihen 12 parqe kombëtare, 718 monumente të natyrës, 23 rezerva të natyrës të menaxhuara, 11 peizazhe të mbrojtura, 14 vende të trashëgimisë botërore e të tjera. Ekosistemi dhe habitatet e saj floristike dhe të faunës janë të shumëllojshme dhe të pasura me biodiversitet. Ne gjykojmë se Shqipëria nuk e ka luksin që të tkurret në pamundësitë e zhvillimit, duke mos e shfrytëzuar 21,4% ose gati 1/5-ën e sipërfaqes së përgjithshme të saj me politika ndalimi ose bllokimi, duke i konceptuar zonat e mbrojtura si ishuj të izoluar, ku të mungojë marrëdhënia dhe përfitueshmëria e komunitetit dhe e turistëve mbi to, si dhe të mos jetë prezent ndërveprimi institucional i qeverisjes vendore me qeverisjen qendrore.

Duke marrë në konsideratë gjithë problematikën sa më sipër, një grup deputetësh bëjnë një reflektim në një këndvështrim më të gjerë për adresimin e këtyre problematikave, me qëllim;

- përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura,
- zgjidhjen e disa problematikave konkrete në terren, që lidhen me informalitetin dhe ndërtimet pa leje që janë kryer gjatë viteve të tranzicionit si ndërtime ilegale brenda territoreve të zonave të mbrojtura, të cilat janë ende të patrajtuara, pasi ka paqartësi ligjore lidhur me ushtrimin e kompetencave, me përplasjen e dispozitave të vetë ligjit për zonat e mbrojtura, si dhe një mospërputhje me sens bllokues të vendimmarrjeve dhe të akteve të nxjerra në kohë të ndryshme,
- harmonizimin midis ligjit për zonat me përparësi zhvillimi, të cilat, janë prioritet kombëtare dhe të zonave të mbrojtura për të shmangur mbivendosjen dhe për të pasur një ecuri paralele mes instrumenteve të planifikimit dhe të zhvillimit të planeve vendore dhe të ndarjes apo përcaktimit të zonave të mbrojtura. Konkretisht, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura që nga viti 2015 kur është krijuar, nuk ka marrë parasysh shumë nga realitetet teksa ka ecur me procesin e hartëzimit të shpalljeve të zonave të mbrojtura. Nga ana tjetër, në një pjesë të bashkive bregdetare shtohet edhe një problematikë tjetër, që ka të bëjë me përplasjen e dy vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit. Konkretisht, vendimi nr. 1 i vitit 2028, që përcakton zonat prioritare për zhvillimin e turizmit, bie ndesh me vendimin nr. 10/2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit ku janë përcaktuar kufijtë e zonave të mbrojtura. Në realitet zonat e përcaktuara në këto dy vendime kanë mbivendosje me njëratjetrën, duke sjellë paqartësi ligjore,
- Garantimin e të drejtave ligjore që banorët e këtyre zonave duhet të gëzojnë për plotësimin e nevojave dhe aksesimin e shërbimeve,
- Vendosjen e rregullave të qarta dhe të përshtatshme për të siguruar mbarëvajtjen e monitoruar të paketave turistike në këto zona, ku në thelb prevalon si primare mbrojtja e tyre, por të krijohen edhe hapësira zhvillimi duke krijuar vende pune, ekonomi dhe perspektivë rajonale.

Ndryshimet e propozuara synojnë të vendosin një ekuilibër midis zonave të mbrojtura dhe nevojës që ka komuniteti dhe pushteti vendor për zhvillimin e agroturizimit, për zhvillimin e aktiviteteve të lejuara në zonat e mbrojtura.

Me qëllim realizimin e këtyre objektivave kemi përgatitur këtë nismë ligjore me propozime konkrete për t'u reflektuar në ligjin nr. 81/2016. Në të gjithë përmbajtjen e propozimeve kemi mbajtur parasysh kushtetutshmërinë, respektimin e ligjeve dhe të rregullave ndërkombëtare të Bashkimit Europian dhe të Unionit Ndërkombëtar të Zonave të Mbrojtura, si dhe kemi mbajtur parasysh sinkronizimin e këtij ligji me të gjitha ligjet e tjera të vendit.

Ligji sjell koncepte të reja të kategorizimit të biodiversitetit në vend sipas rëndësisë, por edhe të mundësisë së përditësimit të tij në mënyrë të shpeshtë; i jep mundësi pushtetit vendor dhe komunitetit të jetë pjesë e vendimmarrjes për zonat e mbrojtura në territorin e tyre; nxit angazhimin dhe ndërveprimin, të sanksionuar me ligj, që ruajtja mbrojtja e diversitetit dhe zonave të mbrojtura nuk duhet të jetë përjashtuese, por gjithëpërfshirëse, duke prezantuar edhe edukimin përmes mjedisit.

Edhe hartimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura propozohet të jetë specifik për çdo zonë, për shkak të tipologjisë, ndërveprimit vendor apo rajonal dhe aksesit që duhet të ketë komuniteti, pushteti vendor dhe institucionet e administrimit të tyre.

Relatori bëri një vlerësim të përmbledhur të projektligjit, duke theksuar se fakti që 21,4%, pra mbi 1/5-ta e territorit të vendit tonë tashmë është zonë e mbrojtur, dhe jo një territor çfarëdo, por pjesa më e bukur e Shqipërisë, dhe me kushtëzimet që ligji ekzistues ka, krijon një ngërç shumë të madh. Kryesisht banorët që banojnë në ato zona biznesi, të mëdha apo të vogla, por edhe pushteti lokal i kanë praktikisht duart e lidhura për të investuar, për të bërë qoftë dhe një kioskë të bukur me dru për të shitur ose për të dhënë informacion për turistët, për të mos folur pastaj për zhvillimet e hoteleve, infrastrukturave akomoduese dhe të gjitha me radhë.

Kryetari i komisionit u shpreh se kjo mazhorancë, qeveria shqiptare, e ka treguar me veprime konkrete përkushtimin e vet ndaj mjedisit, ndaj natyrës dhe ndaj zonave të mbrojtura. Sikurse u theksua, këto ndryshime nuk synojnë këtë gjë. Fakti që 21,5% e territorit është aktualisht zonë e mbrojtur, të cilës i shtohet gjithashtu edhe Parku Kombëtar i Vjosës, tregon më së miri vullnetin e kësaj qeverie. Pikërisht, këto ndryshime propozohen si rezultat i disa shqetësimeve, që kanë lindur në këto zona për të akomoduar bashkëpunimin me komunitetin vendas, që edhe ky komunitet të mund të përfitojë nga zonat në të cilat ndodhen, për të materializuar disa shqetësime, të cilat vijnë si trashëgimi e gjithë këtyre viteve dhe periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Por, nga krahuri tjetër, të mos harrojmë, se kemi edhe një problem demografik jo të vogël, të cilin duhet ta marrim parasysh, siç është shpopullimi i një pjese të këtyre zonave. Sigurisht, në rast se banorëve të caktuar, që ndodhen brenda zonave të mbrojtura, nuk u krijohet asnjë lloj mundësie për të zhvilluar një aktivitet, sado modest, brenda zonave të tyre ku kanë lindur dhe janë rritur, ku kanë jetuar gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre, largimi nga këto zona do

të jetë i pashmangshëm. Kështu që, këtë iniciativë unë e kam mbështetur me shumë dëshirë, e kam asistuar bashkë me grupin e kolegëve, edhe për hir të faktit që drejtoj këtë komision, por edhe si drejtues i Grupit të Gjellbër Vullnetar të Kuvendit të Shqipërisë. Sigurisht, pjesa më e madhe e këtij komisioni jemi anëtarë të Grupit të Gjellbër dhe ne e kemi treguar me veprime konkrete, me investime konkrete se sa i rëndësishëm është mjedisi për ne, sa e rëndësishme është e ardhmja e fëmijëve tanë në këtë vend, dhe, mbi të gjitha, çfarë lufte konkrete jemi duke zhvilluar, në bashkëpunim me qeverinë, për ndryshimet klimatike që po prekin të gjithë globin, në mënyrë të veçantë rajonin dhe Shqipërinë tonë.

Gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit Komisioni u njoh edhe me mendimin e Këshillit të Ministrave për të. Në vendimin nr. 56, dt. 7.2.2024 KM shprehet se Këshilli i Ministrave vlerëson nismën e deputetëve për të propozuar ndryshime në ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, kjo edhe si një nevojë e komuniteteve të këtyre zonave për zhvillim të qëndrueshëm.

Lidhur me nevojën për përditësimin e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, Këshilli i Ministrave shprehet se propozimi për ndryshime në këtë ligj përkon edhe me gjetjet nga dialogu i zhvilluar me qeverisjen e nivelit vendor, në të gjitha bashkitë ndërmarrë nga ministri i shtetit, ku një ndër problemet e konstatuara lidhet me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura që pamundëson shumë bashki në zhvillimin ekonomik sipas modeleve të reja dhe të qëndrueshme në harmoni me mbrojtjen e natyrës. Duke qenë se zonat e mbrojtura mbulojnë hapësira të konsiderueshme brenda territorit të bashkive vlerësohet se rishikimi i këtij kuadri ligjor është një masë e nevojshme e cila duhet të synojë krijimin e një balance të drejtë mes mbrojtjes së mjedisit, krijimit të mekanizmave monitorues në nivel vendor/qendror si dhe procedurave ligjore efektive për shfrytëzimin e këtyre zonave.

Në kuadër të dhënies së mendimit për nismën e propozuar, duke vlerësuar shqetësimin e përfaqësuesve të Kuvendit si dhe të qeverisjes vendore në raport me ligjin e zonave të mbrojtura, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura ka zhvilluar takime me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mjedisit dhe zonave të mbrojtura, me agjenci shtetërore të zbatimit të legjislacionit të zonave të mbrojtura, si Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Territorit, për të çmuar opinionin e tyre lidhur me draftin e përcjellë.

Gjithashtu, të përfshirë në procesin e shtimit të sipërfaqes së zonave të mbrojtura si një prioritet i qeverisë shqiptare për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare botërore të 30% të sipërfaqes së vendit brenda vitit 2030, por edhe në angazhimin e jashtëzakonshëm të shpalljes së Parkut Kombëtar të lumit të fundit të egër në Evropë, Vjosës, nevoja për të përditësuar legjislacionin e zonave të mbrojtura me elemente të administrimit, ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm është një domosdoshmëri. Në kuadër të hartimit të planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të lumit Vjosa në bashkëpunim me partnerë prestigjozë ndërkombëtarë, si Patagonia inc., Unioni Ndërkombëtar i Mbrojtjes së Natyrës etj., një grup ekspertësh ligjorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë kanë depozituar raporte për paqartësi dhe kundërshti të ligjit të zonave të

mbrojtura si dhe kanë sugjeruar ndërhyrje ligjore për t'iu përshtatur zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Bazuar në këto argumente Këshilli i Ministrave vlerëson se nevoja për ndryshime në legjislacionin e zonave të mbrojtura është më se e nevojshme, është e domosdoshme.

Lidhur me përmbajtjen e propozimit të deputetëve Këshilli i Ministrave shprehet se ai nuk është i plotë dhe ka nevojë për një rishikim tërësor në një pjesë të konsiderueshme të propozimeve konkrete të cilat, sipas mendimit të ekspertëve, cenojnë qëllimin e mbrojtjes/ruajtjes së vlerave të zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit.

Me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara nga ekspertët dhe shqetësimet e përcjella nga grupet e interesit për nismën e deputetëve, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndërhyrje konkrete nen për nen.

E pranishme në mbledhjen e komisionit për të dhënë vlerësimin e ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura, znj. Kumbaro falenderoi komisionin për gjithë punën voluminoze të bërë, që nga komunikimet me Njësitë e Qeverisjes Vendore, te dëgjesat e gjata publike me shoqërinë civile, ekspertët, përfaqësuesit e organizatave në lidhje me ndryshimet që propozohen nga grupi i deputeteve në ligjin e zonave të mbrojtura.

Ajo u shpreh se në qeveri i kemi rrahur e diskutuar gjatë nëpër ministritë e institucionet e ndryshme, sipas fushës së kompetencave, propozimet e nismës së deputetëve, por përpara se të shpreh mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me ndryshimet ligjore të propozuara, do të dëshiroja të sillja në vëmendjen e komisionit se në vijim të vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit të vitit 2020, duke nisur nga janari i vitit 2022,

- i dhamë për herë të parë Vjosës statusin e zonës së mbrojtur për ta shpallur në atë kohë Park Natyror,
- luginën e Shalës e bëmë pjesë për herë të parë të zonave të mbrojtura me statusin Park Natyror,
- bashkuam Thethin, Valbonën, Lumin e Gashit duke krijuar Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë, nga Shkodra e Malësia e Madhe deri në Tropojë, me një sipërfaqe të dyfishuar,
- shpallëm Malin e Munellës Park Natyror,
- Syrit të Kaltër, nga thjesht monument natyre, i dhamë statusin e Parkut Natyror të gjithë zonës duke e zgjeruar përreth në një sipërfaqe 290 hektarë,
- u zgjerua Parku Natyror i Ulzës,
- Parku Natyror i Zagorisë që më parë nuk ka qenë fare zonë e mbrojtur.

Pra është kjo mazhorancë që ka rritur sipërfaqen e zonave të mbrojtura nga 17,5% në 21,5% të territorit të Shqipërisë me 12 Parqe Kombëtare, 718 Monumente Natyre, 23 Parqe Natyrore, që ka vendosur moratoriumin e gjuetisë duke rikthyer qetësinë e gjallesave në habitetet e tyre në

këto zona të mbrojtura, që ka vendosur moratoriumin e pyjeve, duke shpallur edhe vitin 2024 si një vit dedikuar pyjeve me një kalendar kombëtar gjithëpërfshirës aktiviteteve

Të gjitha këto tregojnë se mbrojtja e pasurive natyrore të Shqipërisë ka qenë dhe vijon të jetë vizion i kësaj qeverie, është vullnet, është ekspertizë.

Të gjitha këto vendime të mira bënë të mundur që viti 2024 ta gjejë Shqipërinë pjesë të IUCN-së në nivel të shtetit me të drejta të plota brenda organizatës, por sidomos na siguron shkëmbime përvojash më të mira në atë që ne tashmë e kemi caktuar si prioritet, zhvillimin e qëndrueshëm në mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e Zonave të Mbrojtura dhe kthimin e tyre edhe në destinacione turistike natyrore që na sigurojnë një shtrirje të sezonit turistik përtej atij veror, dhe përtej bregdetit, por edhe një shtrirje në territor, ku në përputhje me parimet e IUCN-së, komunitetet duhet të gjejnë mundësitë për bashkejtesë brenda ekosistemeve dhe të mos braktisin territoret ku kanë lindur e ku kanë trashëguar pasuritë e të parëve, por të mund të zhvillojnë ekonomi të qëndrueshme dhe në miqësi me mjedisin.

Ajo që ka ndodhur në këto vite, është se realiteti ka vrapuar shumë më shpejt se ligjet, shumë më shpejt se burokracitë shtetërore, prandaj na rezulton se shpesh herë realiteti në terren nuk përputhet me atë që ne lexojmë në aktet ligjore, ku shumë zona të mbrojtura janë shpallur të tilla para viteve 90'. Në hapësirën e gjatë të tranzicionit, në disa prej këtyre zonave, ka pasur ndërhyrje si ndërtime të paligjshme brenda territoreve të cilat janë akoma të patrajtuara si dhe ka një paqartësi ligjore lidhur me përplasjen e kompetencave, dispozitave të vetë ligjit për zonat e mbrojtura si dhe përplasje të akteve të nxjerra në kohë të ndryshme, qoftë edhe në fushën e turizmit.

Si ministri përgjegjëse për zonat e mbrojtura kemi ndjekur me shumë vëmendje të gjitha diskutimet e bëra në Kuvendin e Shqipërisë për nismën e deputetëve për ndryshimin e ligjit, sikundër kemi zhvilluar takime e konsultime me organizata mjedisore, edhe me agjenci shtetërore të zbatimit të legjislacionit të Zonave të Mbrojtura që nga AKZM, AKM, AKPT, AZHT.

Me qëllim përmirësimin e projektligjit dhe për ta sjellë atë në frymën e parimeve të IUCN-së kemi bërë propozime konkrete për nenet e projektligjit, por do të dëshiroja të veçoja dhe të ndaja me ju propozimin tonë për të krijuar Zyrat e Administrimit të Parqeve Kombëtare, që është një nevojë që e ka diktuar eksperiencia, por na vjen edhe si një rekomandim nga ekspertët e IUCN-së me të cilët kemi punuar për Vjosën, për një menaxhim eficient të atyre sipërfaqeve që kanë shkallën më të lartë të mbrojtjes dhe shumë të shtrirë. Kemi jo vetëm rastin e Vjosës, që përshkon katër qarqe, pra që me ligjin aktual do të duhet të menaxhohet në terren nga katër administrata rajonale të zonave të mbrojtura, duke filluar nga ajo e Korcës, e Gjirokastrës që ka edhe pjesën më të madhe, e Fierit dhe Vlorës, por kemi edhe raste të tjera, si Parku Kombëtar i Alpeve i ndarë mes 2 qarqeve, atij të Shkodrës dhe të Kukësit.

Po kështu, lidhur me propozimin e deputetëve që bashkia përkatëse të administrojë jo më pak se 20% e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që janë në territorin e kësaj bashkie, konstatojmë se pavarësisht se shumë zona të mbrojtura në vendet e Bashkimit Evropian administrohen nga Bashkitë dhe administratat vendore rajonale, ky nen fragmentarizon zonat e mbrojtura në Shqipëri, të cilat janë ngritur për të ruajtur vlerat natyrore me rëndësi kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe për këtë arsye menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Për zonat me rëndësi lokale të ruajtjes së vlerave natyrore, bashkitë mund të krijojnë dhe menaxhojnë "Parqet Bashkiake" ose "Kurorat e Gjelbra" siç përcaktohet tashmë nga Ligji ekzistues për zonat e mbrojtura. Duke vlerësuar bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore gjykojmë se qëllimi i ligjvënësit për t'i ardhur në ndihmë Bashkive mund të arrihet në një proces shumë të rëndësishëm siç është psh "dhënia me qira e kullotave" në zonat e mbrojtura për bagëtitë, por shumë fort i monitoruar nga AKZM.

Gjithashtu, vlerësojmë se ndryshimet në ligjin për zonat e mbrojtura duhet të kenë disa kufij që s'mund të kapërcehen, siç mund të jenë mundësitë për investime të rënda infrastrukturore apo industriale brenda territoreve, dhe këtu kam parasysh ndërhyrjet e propozuara në nenin 8 dhe në nenin 10 të projektligjit të cilat kërkojnë të riformulohen, sepse siç janë, përmes liberalizimit të rregullave, çenojnë objektivat pse një zonë shpallet Park Kombëtar. Prandaj nuk jemi dakord që në të tilla zona të mbrojtura të hapet rruga për veprimtari të tilla ekonomike si hekurudha, sisteme të naftë s apo të gazit me shtrirje të gjatë, e të tjera veprimtari të rënda.

Ministria e Mjedisit vlerëson gjithashtu se është e dosmodoshme të zbatohen rregullat e zonimit dhe të nënzonimit dhe shkalla e mbrojtjes përkatëse në mënyrë që të kemi një ndarje të qartë të klasifikimit të zonave të mbrojtura, por edhe duke marrë parasysh nevojën për zhvillim të qendrueshëm të komunitetit. Zonimi dhe nënzonimi duhet të referojnë zhvillimet e doktrinës ndërkombëtare që referon parime të diferencuara mes zonave të mbrojtura, në përputhje me udhërrëfyesin e IUCN-së.

Propozimet tona për përmirësimin e nismës së deputetëve janë propozime të cilat në thelb synojnë zhvillim e komuniteteve, por duke respektuar elementin e mbrojtjes të biodiversitetit dhe karakteristikave të zones, ku çdo parashikim për ndërhyrje me anë të veprimtarive ekonomike, duhet të jetë në harmoni me natyrën dhe duke mos çenuar elementët thelbësorë të zonës. Pra, në përputhje të plotë me direktivën EU 92/62/EC, konkretisht me nenet 8 dhe 10 të cilat e theksojnë faktin se në rastet kur kemi ndërhyrje në zonat e mbrojtura, në rastet e një interesi publik, duhet të sigurohemi që gjithmonë të jetë në harmoni me biodiversitetin.

Propozimet tona janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit siç janë ato të IUCN-së dhe direktivave Europiane përkatëse, dhe mbi të gjitha me frymën e kohës, për të arritur ekuilibrin e nevojshëm mes mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit, duke përcaktuar qartë zonat ku nuk mund të ndërhyhet, me nevojën për zhvillim të komuniteteve orientuar kah turizmit dhe agroturizmit, në zona që përmes ndërhyrjeve miqësore me mjedisin, mund të ofrojnë struktura që garantojnë cilësinë më të lartë të mikpritjes, na ndihmojnë drejt turizmit elitare, por

edhe i promovojnë më mirë këto territore, prandaj kërkojmë nga ju që të merren parasysh dhe të na krijoni mundësinë të punojme për arritjen e ekulibrit të qartë mes natyrës e aktivitetit njerëzor, për një zhvillim të qendrueshëm, miqësor me mjedisin dhe për të mbrojtur pasuritë e çmuara natyrore.

- ***Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen bazuar në përcaktimet e nenit 38 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni u njoh gjithashtu, edhe raportet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe të Komisionit për Çështjet Europiane, të cilët e shqyrtuan atë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i rekomandon komisionit përgjegjës të adresojë shqetësimet e ardhura nga grupet e interesit, si dhe mendimin e Këshillit të Ministrave të dërguar nëpërmjet vendimit nr 56, datë 7.2.2024, me qëllim hartimin e një varianti të përmirësuar të projektligjit, i cili të krijojë një balancë të drejtë mes mbrojtjes së mjedisit, krijimit të mekanizmave monitorues në nivel vendor/qendror si dhe procedurave ligjore efektive për shfrytëzimin e këtyre zonave.

Komisioni për Çështjet Europiane i rekomandon komisionit përgjegjës që të sigurojë respektimin e parimeve të Direktivës 92/43/KEE, që lidhen me menaxhimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura, duke i trajtuar ato si zona të një rëndësie të veçantë dhe duke siguruar mbrojtjen mjedisore dhe të biodiversitetit të natyrës në to, si dhe parimet e IUCN-së, në të cilat përcaktohet se konsiderohen zona të mbrojtura ato të cilat kanë si objektiv kryesor dhe synojnë ruajtjen e natyrës ose, në mënyrë ideale, të rrisin shkallën e natyralitetit të ekosistemit që mbrohet dhe të parandalojnë, ose eliminojnë aty ku është e nevojshme, çdo praktikë shfrytëzimi ose menaxhimi që është e dëmshme për këtë objektiv.

Për këtë arsye sugjerohet që neni 7 shkronja (d) dhe (dh), neni 8, pika 3, shkronja (f) dhe neni 10, pika 1, i projektligjit, të rishikohen për të qenë në përputhje me nenin 108 të MSA-së, nenin 37 të Kartës të të Drejtave Themelore të BE, në linjë me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, konkretisht nenin 6, pika 2, 3 dhe 4 të saj, si dhe në linjë me parimet e IUCN-së.

Pas diskutimit, shqyrtimit dhe miratimit në parim të projektligjit, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, pasi:

- Administroi, shqyrtoi dhe adresoi të gjitha shqetësimet, komentet dhe rekomandimet e paraqitura nga grupet e interesit nëpërmjet platformës së konsultimit publik, nëpërmjet postës elektronike të komisionit, atyre që u dëgjuan në seancat dëgjimore të zhvilluara në komision;

- administroi dhe adresoi mendimin e Këshillit të Ministrave për projektligjin, të dërguar me VKM nr. 56, datë 7.2.2024 “Mendim për projektligjin jo qeveritar “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”;
- administroi dhe adresoi rekomandimet e komisioneve parlamentare që e shqyrtuan projektligjin në cilësinë e komisioneve për dhënie mendimi,

vlerësoi që drafti ka nevojë për ndryshime me qëllim që të adresohen problematikat e evidentuara dhe meqenëse ndryshimet në projektligjin e propozuar janë të shumta (numri i neneve që hiqen, i atyre që riformulohen dhe i atyre që shtohen është i konsiderueshëm), vendosi që në aspektin formal të hartojë dhe të miratojë një variant integral të projektligjit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij raporti.

• *Ndryshimet nen për nen*

Ndryshimet që janë bërë nga komisioni në tekstin e projektligjit të propozuar nga deputetët konsistojnë në:

- Shtimin e një neni i cili bën disa saktësime dhe shton disa përkufizime dhe në nenin 3 të ligjit;
- Riformulimin e nenit 1 në aspektin e tektnikës legjislativë;
- Heqjen e nenit 2, pasi vlerësohet se është një nen deklarativ që nuk ka vlerë të shtuar në përditësimin e politikave shtetërore për administrimin e zonave të mbrojtura;
- Heqjen e nenit 3, pasi vlerësohet se në ligjin aktual janë të parashikuara kompetencat dhe funksionet e institucioneve shtetërore për mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura;
- Heqjen e nenit 4, pasi vlerësohet se ligji aktual e rregullon edhe aktivitetin e vizitueshmërisë së zonave të mbrojtura;
- Heqjen e nenit 5, pasi vlerësohet se ky amendim është i panevojshëm pasi në klasifikimet e zonave të mbrojtura në ligjin aktual janë edhe parqet bashkiake;
- Heqjen e nenit 6 pasi vlerësohet se fragmentarizon zonat e mbrojtura në Shqipëri, të cilat krijohen për të ruajtur vlerat natyrore me rëndësi kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe për këtë arsye menaxhohen nga AKZM. Për zonat me rëndësi lokale të ruajtjes së vlerave natyrore, bashkitë mund të krijojnë dhe të menaxhojnë “Parqet bashkiake” ose “Kurorat e gjelbra”, siç përcaktohet tashmë nga ligji ekzistues për zonat e mbrojtura;
- Riformulimin e nenit 7, me qëllimin që të përcaktohen qartë objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura, bazuar te parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, duke riformuluar vetëm shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të dispozitës në fuqi. Në këtë mënyrë adresohet edhe rekomandimi i Komisionit për Çështjet Europiane për këtë nen;
- Riformulimin e nenit 8 duke vlerësuar se propozimi i deputetëve për këtë nen, i cili lidhet ngushtësisht me përfitimet e komunitetit lokal që jeton në zonat e mbrojtura, është i

drejtë, por në formën e propozuar nuk reflekton kuadrin më të gjerë socio-ekonomik të këtij procesi. Është adresuar edhe rekomandimi i Komisionit për Çështjet Europiane për këtë nen;

- Shtimin e një neni që nen shfuqizon pikën 2 të nenit 12, me qëllim harmonizimin me dispozitat që lidhen me zonimin dhe nënzonimin;
- Riformulimin e nenit 10, pasi vlerësohet se ky propozim nuk është i saktë dhe nuk reflekton mënyrën e konservimit, mbrojtjes dhe menaxhimit të një Parku Kombëtar, pasi ai jep miratim dhe për ndërtimin e hekurudhave, hidrocentraleve dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë. Është adresuar edhe rekomandimi i Komisionit për Çështjet Europiane për këtë nen;
- Riformulimin e nenit 11, pasi vlerësohet se megjithëse është i nevojshëm ndryshimi i nenit 17 të ligjit, sepse nuk është në harmoni me udhëzuesin ndërkombëtar të IUCN për të shpallur një zonë të mbrojtur dhe nuk reflekton plotësisht kategorinë III për të cilën shpallet, ai ka nevojë për riformulime;
- Riformulimin e nenit 12, pasi vlerësohet se ndryshimet që propozohen në Rezervatin Natyror të Menaxhuar/Park Natyror” sa i takon shfrytëzimit dhe zënies së zonës me aktivitete të cilat bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje, duhet të përshtaten në teknike legjislative dhe logjike aplikimi me nenin 16 të ligjit nr.81/2017 që lidhet me kategorinë II, duke ruajtur karakteristikat e kategorisë IV, për të garantuar një zbatim të qartë të këtij neni në shpalljen e zonave të mbrojtura, përdorimin e aktit ligjor për secilin park natyror/ rezervat natyror të menaxhuar;
- Riformulimin e nenit 13, pasi vlerësohet se propozimi vjen si rrjedhojë e tipologjisë së kategorisë së mbrojtur, e cila, bazuar në referimin e udhëzuesit të IUCN përcaktohet si “Një zonë e mbrojtur ku ndërveprimi i njerëzve dhe natyrës me kalimin e kohës ka prodhuar një zonë me karakter të veçantë me vlera të rëndësishme ekologjike, biologjike, kulturore dhe skenike. Kategoria V nuk i jep përparësi kërkimit, megjithëse mund të ofrojë mundësi për të studiuar ndërveprimet midis njerëzve dhe natyrës. Kategoria V përfshin opsionin e ndërveprimit të vazhdueshëm njerëzor. Zonat e mbrojtura të kategorisë V nuk janë "shkretëtira" siç përcaktohet nga IUCN;
- Heqjen e nenit 14, pasi vlerësohet se amendimi i nenit 21 të ligjit në fuqi është i panevojshëm, pasi planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi hartohen nga AKZM-ja dhe miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura dhe çdo zonë e mbrojtur në RSH duhet të ketë aktin ligjor të dedikuar;
- Riformulimin e neneve 15-17, të cilat propozojnë një qasje të unifikuar të përcaktimit të veprimtarive duke lënë një liri propozimi dhe veprimi në planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, përveç atyre të përcaktuara në nenet 33 dhe 34;
- Riformulimin e nenit 18, pasi vlerësohet se me qëllim për të pasur qartësi në veprimtaritë e lejuara *ex lege*, neni 33 i ligjit duhet të riformulohet i gjithi, në frymën e propozimit integral të të gjitha neneve të projektligjit;

- Shtimin e një neni që ndryshon nenin 36 të ligjit, për ta harmonizuar me ndryshimet që u bënë lidhur me elementet tekniko formale;
- Shtimin e një neni në kuadër të nevojës për përshtatjen e ndarjes mes klasifikimeve të zonave të mbrojtura;
- Heqjen e neneve 19-20, pasi vlerësohet se këto nene do të gjejnë garanci më të plotë nëse do të adresohen në disa nene të tjera në tekstin e ligjit nr.81/2017 dhe konkretisht në nenet 56,57,66, 67 dhe 69, të cilët shtohen si nene të rinj në tekstin e projektligjit;
- Shtimin e një neni i cili krijon Zyrën e Administrimit të Parqeve Kombëtare (ZAPK), për të adresuar qëllimin e propozuesve për nenet 2, 3 dhe 4 të projektligjit, të cilat u hoqën;
- Shtimin e një neni për të adresuar qëllimin e propozuesve për t'i ardhur në ndihmë bashkive nëpërmjet “dhënies me qira të kullotave” në zonat e mbrojtura për bagëtitë, në koordinim me pushtetin vendor;
- Shtimin e 4 neneve që ndryshojnë nenet 47, 48,49,50 të ligjit, me qëllim për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave në fuqi mbi zonimin;
- Shtimin e tre neneve që ndryshojnë nenet 56,57,66,67 dhe 69 të ligjit, me qëllim për të krijuar mundësitë për rishikimin e planit të menaxhimit nga AKZM-ja, mbështetur në parimin e përshtatshmërisë dhe nevojës për rishikimin e planit të menaxhimit, pas heqjes së neneve 19 dhe 20 të projektligjit.
- Ndryshimin e nenit 21 me qëllim ripërcaktimin e afateve për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe detyrave të institucioneve zbatuese.

• PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, vlerësoi se projektligji:

Në aspektin ligjor, është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

Në përfundim, Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, miratoi variantin integral të projektligjit në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për miratim në seancë plenare.

RELATOR

Laert DURAJ

KRYETAR

Arben PËLLUMBI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2024

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2017 “PËR ZONAT E MBROJTURA”

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me përmbajtje si vijon:
“6/1. “Elementë tekniko-formal të shpalljes së zonës së mbrojtur”, janë emërtimi i zonës së mbrojtur, institucioni menaxhues, zonimi dhe nënzonimi si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe ndaluara për zonën e mbrojtur ose secilën nënzonë të saj kur aplikohet.”
2. Pas pikës 25, shtohet pika 25/1 me këtë përmbajtje:
“ 25/1. Turizëm i ekselencës” në kuptim të këtij ligji, është lloji i turizmit, i cili ofron akomodim në struktura me standardet më të larta arkitektonike e mjedisore, si dhe shërbime turistike ekskluzive të nivelit më të lartë.”

3. Në pikën 36, pas fjalës “tradicionale” shtohet togfjalëshi “ekonomike dhe turistike, duke përputhur objektivin e mbrojtjes, efektivitetit, dhe përshtatshmërisë, me veçoritë që paraqet zona e mbrojtur ose nënzona”.

4. Pas pikës 37, shtohen pikat 38 dhe 39 me këtë përmbajtje:

“38. “Zonë natyrore e pashqetësuar”, është zona në të cilën garantohen elementët thelbësorë të biodiversitetit, ekosistemeve, specieve dhe karakteristikat e gjeodiversitetit të zonës, në një gjëndje natyrore ku, veprimtaria njerëzore është në harmoni me elementet e natyrës, në mënyrë që zona të vijojë të ruajë karakteristikat e saj.

39. “Zonë natyrore pak e shqetësuar”, është zona në të cilën garantohen elementët thelbësorë të biodiversitetit, ekosistemeve ku veprimtaria njerëzore projektohet dhe zhvillohet me elemente dhe/ose struktura të tilla që krijojnë harmoni me elementët e natyrës, në mënyrë që zona të vijojë të shfaqë karakteristikat e saj dhe të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm.”

Neni 2

Në nenin 4, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” “dh” “e”, me këtë përmbajtje:

“d) “Parimi i përshtatshmërisë”. Kategoria e një zone të mbrojtur duhet të ndryshohet nëse nga vlerësimi i saj në një kohë të dhënë rezulton se karakteristikat dhe objektivat për të cilat zona e mbrojtur është shpallur nuk përputhen me ato të kategorisë të caktuar.

dh) “Parimi i kategorizimit sipas objektivave”. Përcaktimi i kategorisë së zonës së mbrojtur sipas këtij ligji duhet të kryhet në përputhje me objektivat kryesorë të shpalljes të secilës kategori të zonave të mbrojtura.

e) “Parimi i fleksibilitetit të menaxhimit”. Zonat e mbrojtura menaxhohen sipas çdo forme menaxhimi/administrimi, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen ndryshimet, si vijon:

1. Në shkronjën “c)” fjala “moslejimin ” zëvendësohet me fjalën “kufizimit”.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si vijon:

“ç) të ruajë hapësirën e shpallur zonë e mbrojtur dhe përbërësit natyrorë të saj, me qëllimin për të siguruar vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë elementeve të biodiversitetit, duke përdorur strategji menaxhimi të përshtatshme dhe menaxhim efektiv në kohë.”

3. Shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“d) të vlerësojë në përputhje me parimet e objektivave të shpalljes së zonës së mbrojtur mundësinë për veprimtari ekonomike turistike dhe infrastrukturë mbështetëse për to brenda zonës dhe nevojat e komunitetit”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen ndryshimet, si vijon:

Pika “1” shfuqizohet.

Në pikën 3, pas togfjalëshit “së nënzonave të zonës së mbrojtur”, shtohet togfjalëshi “si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara për zonën ose secilën nënzonë të zonës që do të shpallet, si dhe përdorimi i të ardhurave që krijohen”.

Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si vijon:

“ç) një raport i efekteve në mjedis duke përfshirë proceset dhe veprimtaritë e lejuara”.

2. Shkronjat “d” dhe “dh”, shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 12 pika, 2 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 13 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 16 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë :

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pjesa hyrëse ndryshohet si vijon :

“1. Në “Parkun kombëtar”, me përjashtim të infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes, me standartet më të larta arkitektonike dhe mjedisore për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji,

zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:”

2. Shkronja “a” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“a) nuk lejohet shfrytëzimi ose zënia e tokës për asnjë arsye tjetër”.

3. Shkronja “d” shfuqizohet.”

2. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

1. Pjesa hyrëse ndryshohet, si vijon:

“3. Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur si dhe ato të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, që sigurojnë krijimin e mundësive shpirtërore, shkencore, edukative, çlodhëse të vizitorëve, në përputhje me kërkesat mjedisore, kulturore, por vetëm pasi të pajisen me miratimin e institucioneve shtetërore, që synojnë:”.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me përmbajtje si vijon:

“ç) dhënie e kontributit në ekonominë vendase, nëpërmjet veprimtarive të turizmit/agroturizmit.”

3. Në pikën 4, pas togfjalëshit “ruajtjes së zonës ” shtohet togfjalshi “nëse nuk përcaktohen si veprimtari të lejuara apo në mbështetje të këtyre veprimtarive”.

4. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“5. Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se nga veprimtaritë e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni cënohet qëllimi për të cilin zona është shpallur “Park kombëtar”, mund të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht këto veprimtari dhe të kërkojë nga AKZM miratimin përfundimtar të kufizimit ose ndalimit të këtyre veprimtarive.”

5. Pika 7 ndryshohet si vijon:

“7. Këshilli Kombëtar i Territorit, në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posacme miraton rregullat dhe kriteret teknike të zhvillimit të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara”.

Në nenin 17 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2, fjalia e parë shfuqizohet.
2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “edukative ” shtohet fjalët “turistike dhe agroturistike”.
2. Në pikën 3, pas togfjalëshit “në parkun natyror” shtohet togfjalëshi “me përjashtim të veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji”.
3. Në pikën 4, pas togfjalëshit “administratës së zonës së mbrojtur” shtohet togfjalëshi “nëse janë të ndryshme nga veprimtaritë e lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur apo ato të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji”.
4. Pika 6 ndryshohet si vijon:
"6. Këshilli Kombëtar i Territorit, në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posacme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara."

Neni 10

Në nenin 20 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia “me këtë përmbajtje:

“Kategoria e peizazhit të mbrojtur krijon mundësi për zhvillime bashkëkohore si veprimtari turistike/agroturistike apo veprimtari të tjera ekonomike të qëndrueshme, miqësore me biodiversitetin.”

2. Në pikën 2, pas fjalëve “çlodhje dhe argëtim” shtohen fjalët “turizëm/agroturizëm”.

3. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

1. Pas togfjalëshit “peizazh të mbrojtur”, shtohet togfjalëshi “në përputhje me rregulloren e posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit”.
2. Pas togfjalëshit “zbatohet shkalla”, shtohet fjala “e tretë”.
3. Në shkronjën “c”, togfjalëshi “eliminimin, kur është e domosdoshme, dhe parandalimin” zëvendësohet me togfjalëshin “kufizimin”.
4. Pas shkronjës “dh”, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) lejimin e ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacioni apo ekonomike brenda zonës, duke ruajtur karakterin e zonës sipas parashikimeve të këtij ligji dhe VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur.”.

4. Pika 6 ndryshohet si vijon:

“6. Në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur caktohen veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara.

5. Pas pikës “6” shtohet pika “7” me këtë përmbajtje:

“7. Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 11

Në nenin 22 bëhen ndryshimet, si vijon:

1. Në pikën 2, pas togfjalëshit “objektivat e mbrojtjes”, shtohet togfjalëshi “që përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“ 2/1. Në “zonën e mbrojtur detare” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij neni, nenit 33, nenit 34, si dhe VKM-së për shpalljen e zonës së mbrojtur.”

3. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

1. Pas togfjalëshit “në këto zona”, shtohet togfjalëshi “me përjashtim të veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve në VKM-në e shpalljes së zonës dhe/ose nenin 33 të këtij ligji”.
2. Shkronja “ë” ndryshohet si vijon:

“ë) tjetërsojnë territorin e habitateve apo të peizazhit me aktivitete minerare apo të shfrytëzimit të gazit e të naftës;”

4. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.

Neni 12

Në nenin 23, pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 13

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 togfjalëshi “me urdhër të ministrit dhe i dërgohen për zbatim bashkive menjëherë sapo të miratohet zona e parkut” zëvendësohet me togfjalëshin “urdhër të Kryetarit të Bashkisë”.
2. Në pikën 5 togfjalëshi “ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura”, zëvendësohet me togfjalëshin “Kryetari i Bashkisë”.

Neni 14

Neni 33 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 33

Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura

Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore janë:

1. Veprimtaritë e përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur dhe të zbatuara sipas kriterëve të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit;
2. veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të ekselencës, 5 yje ose më shumë, në fushën e turizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre pavarësisht nëse kjo përcaktohet në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur;
3. veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të agroturizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre pavarësisht nëse kjo përcaktohet në vendimin e shpalljes së zonës së mbrojtur;

4. veprimtaritë me qëllim të monitorimit të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
5. çdo veprimtari që lidhet me ndërhyrjet e nevojshme ose urgjente për përmirësimin e biodiversitetit, rigjenerimit ose shëndetësimin, ose çdo veprimtari tjetër për këtë qëllim;
6. veprimtaritë ushtarake, të cilat mund të ushtrohen pasi të jenë pajisur me leje mjedisore.”

Neni 15

Në nenin 36 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si vijon:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Propozimi për ndryshimin e sipërfaqes së zonës bëhet nga AKZM, ministrinë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organe shtetërore kolegjiale qe miratojnë projekte dhe veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, institucionet kërkimore-shkencore, shoqëria civile dhe nga pronarët privatë, kur në zonën e mbrojtur janë përfshirë edhe pronat e tyre, si dhe nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonë, të pajisur me leje mjedisi. Propozimi konsultohet paraprakisht me komunitetin vendas, me pronarët, pronat e të cilëve, sipas rastit, përfshihen ose hiqen nga sipërfaqja e zonës, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda zonës, me institucionet shkencore, me organet e qeverisjes vendore ku shtrihet zona dhe argumenton nevojën e ndryshimit.”

Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Miratimi i ndryshimit të një apo më shumë elementëve formalë të vendimit të shpalljes së zonës së mbrojtur bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura, ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret pas marrjes së vendimit të KKT-së në rastin e ndryshimit të zonimit dhe nënzonimit.”

Neni 16

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 36/1

Ndryshimi i elementëve tekniko-formalë

1. Miratimi i ndryshimit të elementëve tekniko-formalë të vendimit të shpalljes së zonës së mbrojtur si emërtimi, institucioni menaxhues, zonimi dhe nënzonimi si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara për zonën e mbrojtur ose secilën nënzonë të saj, bëhet

me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura, ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës, pas marrjes së vendimit të KKT-së në rastin e ndryshimit të zonimit dhe nënzonimit.

2. Në rastet e parashikimeve të pikës 2, 3 dhe 4 të nenit 33 miratimi i rregullave dhe kriterëve teknike të zhvillimit nga ana e KKT konsiderohet akt i ndryshimit”.

Neni 17

Pas nenit 39, shtohet neni 39/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 39/1

Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare

1. Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare (ZAPK) është institucion tekniko-administrativ në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, e cila ushtron veprimtari brenda territorit gjeografik të zonës së mbrojtur Park Kombëtar, territori i veprimtarisë së të cilës përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e saj.
2. ZAPK-të, brenda territorit të veprimtarisë së tyre ushtrojnë kompetenca administrimi si dhe miratojnë në koordinim me AKZM-në propozimet për plane menaxhimi në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
3. Planet e menaxhimit, projektet restauruese dhe konservuese, projektet kërkimore-shkencore, të ZAPK-ve, shqyrtohen, koordinohen me AKZM dhe miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e zonës së mbrojtur.
4. ZAPK-të kryejnë punime mirëmbajtjeje dhe mund të kryejnë punime me karakter restaurues e konservues, në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse në zonat e mbrojtura që kanë në administrim.
5. ZAPK-të, në varësi të veçorive natyrore, ambientale, të florës dhe faunës, në tokë dhe në ujëra, bashkëpunojnë dhe koordinojnë me institucionet e fushave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në territorin që administrojnë.
6. ZAPK-të mbikëqyrin efektet mjedisore të çdo ndërhyrjeje apo zhvillimi të propozuar brenda territorit të tyre gjeografik sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

7. ZAPK-të mbajnë lidhje të vazhdueshme dhe informojnë strukturat e qeverisjes qendrore e vendore për zhvillime të karaktereve të ndryshme, që kryhen jashtë territorit të tyre, por që mund të kenë impakt në to.

8. Krijimi i Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar, struktura dhe organika e saj miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.

9. AdZM-të pjesë e territorit të të cilave janë parqet kombetare në të cilat janë krijuar ZAPK-të, përjashtohen nga detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre zonave të mbrojtura mjedisore.

10. ZAPK-të brenda territorit të veprimtarisë së tyre, ushtrojnë cdo funksion administrimi, menaxhimi që ligji parashikon për AdZM-të.

11. Mënyra e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së ZAPK-ve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

12. Struktura dhe organika e tyre miratohet me urdhër të Kryeministrit. ”

Neni 18

Në nenin 40 pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Gjatë ushtrimit të funksionit të dhënies për përdorim të përkohshëm të territoreve kullota, pjesë e zonës së mbrojtur, AdZM-të apo ZAPK-të lidhin kontratë tri palëshe me bashkinë dhe subjektet e interesuara.

2/2. Bashkia, në përmbajtje të kontratës, përcakton vendndodhjen dhe sipërfaqen e dhënë në përdorim duke e vlerësuar atë në raport me kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara në momentin e njoftimit për aplikim. Me lidhjen e kontratës tri palëshe, sipas këtij neni, bashkia bëhet përfituese e të ardhurave që vijnë nga përdorimi i përkohëshëm i kullotës. Procedura rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.”.

Neni 19

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas togfjalëshit “territori zonës së mbrojtur” shtohet togfjalëshi “për kategoritë “Park kombëtar” dhe “Rezervat natyror i menaxhuar/Park Natyror”.

2. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Zonimi i brendshëm përmban nënzonën qendrore, nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe nënzonën e rekreacionit dhe është pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave që shpall zonën e mbrojtur.”

3. Në pikën 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme përcakton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse për projekte specifike të lidhura me zbatimin e veprimtarive të lejuara në të cilat zbatohen shkalla e parë, e dytë dhe e tretë e mbrojtjes.”

4. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 20

Neni 48 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 48
Nënzona qëndrore

1. Në nënzonën qëndrore të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.
2. Veprimtaritë e ndaluara në nënzonën qendrore të një zone të mbrojtur mjedisore janë:
 - a) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;
 - b) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;
 - c) ndezja e zjarreve;
 - d) gjuetia;
 - e) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të “Parkut kombëtar”;
 - f) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
 - g) riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;
 - h) ndërtimi i autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;
 - i) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;
 - j) mbjellja e pyjeve monokulturë;
 - k) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;
3. Veprimtaritë e lejuara në nënzonën qendrore përvec atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”

Neni 21

Në nenin 49 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e nenit togfjalëshi “tradicional dhe”, hiqet.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, nëse nuk janë në funksion/mbështetje të veprimtarive të lejuara, janë të ndaluara.”.

3. Pas paragrafit të parë, shtohet një pikë 2 me këtë përmbajtje:

“ 2.Veprimtaritë e lejuara në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm përveç atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”

Neni 22

Në nenin 50 bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe të rekreacionit të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, nëse nuk janë në funksion/mbështetje të veprimtarive të lejuara, janë të ndaluara.”.

2. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Veprimtaritë e lejuara në nënzonën rekreative, përveç atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”

Neni 23

Në nenin 56, në pikën 1, pas togfjalëshit “e parashikuar në ” shtohet togfjalëshi “në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur ose”.

Neni 24

Në nenin 57, në pikën 3, pas togfjalëshit “zonave të mbrojtura administrohen” shtohen fjalët “nga ZAPK ose”.

Neni 25

Kudo në përmbajtjen e neneve 66, 67 dhe 69 fjalët “Inspektorati i Policisë Pyjore/Inspektorët e Policisë Pyjore/Inspektori ” zëvendësohen me fjalët “AKZM-ja dhe trupat inspekutese të AdZM-ve rajonale”.

Neni 26

Në nenin 74, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5, me përmbajtje si vijon:

“4. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe KKT marrin masa të sigurojnë konformitetin e elementëve tekniko-formal të vendimeve të shpalljes së zonave të mbrojtura me parashikimet e këtij ligji.

5. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura miratojnë aktet e nevojshme për shpalljen e zonave të mbrojtura në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I
LINDITA NIKOLLA